

INXHINIERI | ARKITEKT

KARL GHEGA

Mjeshtri shqiptar i ndërtimit të hekurudhës së parë malore në botë

Në arkiv zbulohen dokumente mbi jetën, zbulimet, aventurat profesionale, çmimet dhe nderimet e shumta, si dhe vdekjen e hershme të mjeshtrit, që bota e kujton me nderim edhe sot...

Nga Pjeter Logoreci

Vizitori që udhëton me tren nga Vjena në drejtim të Graz-it, mrekullohet nga pamjet e rralla të natyrës malore të zonës së Semmering-ut. Menjëherë të mahnit bukuria e udhës së hekurit që gjarpëron në mes faqeve shkëmbore, që përshkon Ura e Viadukte, e që zhduket vazhdimisht një pas një nëpër 15 tunelet, duke ofruar pamje të mrekullueshme të vendeve të Semmering-ut të mbulueme nga gjelbërimi i pishave.

SEMMERINGBAHN qubet në gjuhën e vendit - hekurudha e Semmering-ut, një mrekulli arkitekturore e përmasave botnore, e cila asht e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me emrin e arkitektit me origjinë shqiptare KARL GHEGA.

Hekurudha e Semmering-ut në kohën e saj u cilësue si "kombinacion në mes gjenisë së Karl Ghegës, teknologjisë dhe natyrës". E ndërtueme 158 vjet ma parë, kjo hekurudhë, 41 km e gjatë nga Gloggnitz deri në Mürrzuschlag, është e vlerësue me jo vetëm nga vjetërsia e saj, por edhe se: në vitin 1854, kjo vepër ishte hekurudha e parë malore e botës, gjë për të cilën u vendos më vonë në 1998-tën në listën e veprave të TRASHHEGIMISE KULTURORE BOTERORE të UNESCO-s.

Kush ishte Karl Ghega - i njohtun në arenën ndërkombëtare si CARL RITTER VON GHEGA?

Për ato që mund të vizitojnë Venzian, po të kalosh nga Piazza San Marco nëpërmes një sheshit të vogël, në shëtitoren Riva degli Schiavoni, përpara Hotel Danieli e statujës së Viktor Emanuelit II, nëpër Via Giuseppe Garibaldi në Fondamenta Sant'Anna, gjindet Calle San Giocchino, në një qoshe të së ciles ka lindë personazhi i shkrimit tim Carlo Ghega.

Kjo shtëpi e thjeshtë, e cila në pamje të parë të duket si fasada e mbrapme e një kishë, ka në murin saj një pllakë perkujtimore mermeri ku shënohet lindja e Cavaliere Carl Ghega's.

Në këtë shtëpi me 10 Janar 1802 lind i mjeshtri me famë botnore i ndërtimit të hekurudhave Austriake, Karl Ghega.

Karli ishte djali i vetëm i oficerit të marinës Anton Ghega dhe Anna Pribich të cilët kishin edhe tri vajza.

Simbas regjistrimit të pagëzimit të famullisë San Pietro, me nr.34, në faqe 183: me 10 Janar të vitit të bekuem prej Zotit 1802, u lajmërua lindja e Karlit, i biri i zotni Anton Ghega djalë i Gasprit (Kaspar), Oficer i marinës dhe zonjës Anna e lindun Pribich e bija e Gjergjit (Georg), grueja e tij e ligjëshme, i cili jeton në Fondamento di San Giocchino.

Kumbara i pagëzimit: zotni Andre Contuzzi i biri i Nikollës - oficeri marinerit nga famullia e S. Giuliano. Mamija: Aleksandra Longo. Spigarol di contrada. Prifti: Peter Lanza - Fa-

mullitar.

Kisha San Pietro di Castello në ishullin Olivolo në Venezia ishte vendi ku u pagëzue me 10 Janar 1802 i porsalinduni Karl Ghega, vend ku gjindet selia e banimit të Ipeshkvit të Venezas.

Lidhur me ditën e lindjes të Karl Ghegës nuk ka asnjë dyshim në saktësi, por në arkivën e Shtetit Austriak, në kartelën me të dhënat biografike të punës së Karlit shënohet 13 Korriku 1802 si data e tij e lindjes. Nuk dihet se si mund të jetë ba një gabim i tillë pa u kuptue nga administrata, por historishkruesi i librit mbi hekurudhat Bruno Enderes hamendëson se dikur në vendet kris-

tiane, festohej dita e emnit me shumë se ditëlindja dhe shpesh fiksohej si ditëlindje.

Familja e Karlit kishte si traditë që prej disa generatash, marinën. Paraardhësit e tij kishin shërbyer si oficerë të marinës në republikën e Venecias. Babai i Karlit, Antoni ishte i oficer i teknikës në marinë dhe mbante uniformën e k.k. Marinësflutarak. (Kaisertum Österreich und Königreich Ungarn Kriegsmarine).

Sipas autorit Alfred Niel i cili ka shkruar biografinë e Karl Ghega's në 1977: prejardhja e familjes Ghega është nga Shqipëria. Kjo shpjegohet edhe me kuptimin e fjalës Ghega në gjuhën shqipe, spjegon Niel. Autori i

referohet edhe priftit franceskan shqipëtar Dr. Phil. Paulin Margjokaj, i cili ka jetue në Vjenë e që ndoqi gjurmët e prejardhjes së familjes Ghega. Sipas gjurmimeve historike të tij, mbasi në 1478-tën turqit pushtuen Shkodrën, Venezianet u larguen nga qyteti i Shkodrës duke marrë me vete edhe shumë familje qytetare shkodrane që punuen për to. Të gjithë këto shqiptarë qenë vendosun në një zonë të qytetit të Venecias dhe thirrreshin nga vendasit Gegët/Ghegët (në italishte Gh mbasi ka një ton ma të fortë artikullimit).

Po kështu edhe studiuesi dhe autori i librit tjetër për Karl Ghegën - Eölgang Straub, si dhe autorë të tjerë


e biografë si Gerhard Artl, Günther Dinobli, Mihaly Kubinnszky, e lidhin prejardhjen e familjes Ghega me Shqipërinë.

Qysh në moshën e fëmijnisë Karlettoja ishte një nxënës që pati rezultate të shkëlqyera dhe tregoi prirje të veçanta në matematikë dhe në ndërtimin e objekteve mësimore. Bazat fillestare të mësimin ai i mori në familje ku dhe u edukue nën një disiplinë të rreptë. I jati duke pa talentet e djalit të vetëm në mes të tri motrave, vendosi të vazhdoje traditën familjare dhe ti japë atij drejtimin e oficerit të marinës, por që Karli nuk e dëshiron-te. Kështu që në moshën 12 vjeçare ai u shkëput nga mësimet e marinës e




Në foto: (Majtas) Karl Gega (Lart) Shtëpia, në murin e të cilës duket pllaka perkujtimore ku shënohet lindja e Cavaliere Carl Ghega-s (Poshtë) Kisha San Pietro di Castello ku u pagëzue me 10 Janar 1802 i porsalinduni Karl Ghega





Në foto: (Lart) **NONIUS-I, vegël që përdorej për stakimin e harqeve, një nga zbulimet e Karl Gegës. (Djathtas) Karl Gega**



Në foto: Me 1833 përfundoj studimin teorik të Nonius-it dhe e botoj në librin "DELL' OTTANTE A DIOTTRA"

me këshillën e mësuesve, në Kolegjin ushtarak të Sant Annës në Venecia, vazhdoi kursin e matematikës dhe filozofisë, të cilat i mbaroi me sukses të veçantë. Qysh në këtë moshë Karli shihet nga të tjerët si "kokë e ndritur" dhe zotonte gjuhën frënge e po ashtu gjermanishten, të cilën e kishte gjuhën e nanës, e cila vinte prej familjes Pribich nga Istrien në gjun e Triestes. Në moshën 15 vjeçare ai mori Diplomën e "licenziato Ingiere e architeto a pieni voti". Për të ndjekun prijzen e tij, në këtë moshë u largu nga Venecia për në Universitetin e Padova's ku filloi studimet 3 vjeçare për Matematikë dhe shkencë të natyrës në Janarin e vitit 1818, direkt në vitin e dytë. Në certifikatën e regjistrimit në Universitetin e Padova's shkruhet: "ka mesue në kolegjin ushtarak të Sant Annës në Venecia këto lëndë: Arithmetikë, Gjeometri, Trigonometri, Algjebër, Fizikë, Hidrologji, Pendeltheorie, Shkencë mekanike. Edhe në vjetin e dytë të Universitetit ai arrin që për 7 muajt të përvetësojë të gjitha lëksionet, e në gusht të 1818 të kryejë provimet vjetore duke mbyllë krejt vitin universitar. Eshhtë gati e pabesueshme të mendosh se qysh në tetor 1817 ai frekuentonte përmjeherë me Universitetin edhe një shkollë private "Inspezione centrale d' Acque e Strade" në Venecia. Ecejaket në mes Padova's dhe Venecias i krijuan mundësinë që teoritë e universitetit të vinte në praktikë në Venecia ku hyri në inspektoriatin e Hidrologjisë dhe të Rugëve si nxënës praktikant. Ai ishte kërkues ndaj vetes dhe duke pa rezultatet e larta e të shpejta të tij, në periudhën e pushimeve verore, e pranuen në një kurs arkitekture në Acaemia di Belle Arti te Venecias. Karli përveç se ishte talent i orientuem nga shkencat e matematikës, pat edhe fatin që të merrte mësim nga profesorë me famë botnore në shkencat e natyrës, si matematikani Giuseppe Avanzini, i cili ishte specialist në zhvillimin e fushës së Hydro e Aerodinamikës, ose Giovanni Farini profesor i historisë së natyrës dhe marrdhanieve në mes Teknikës dhe Filozofisë. Mbas provimeve të 1918-ts ku mori titullin Ingiere Architetto tashma nën drejtimin e këtyne profesorëve shkencëtare, Karli mbylli provimet e diplomës universitare me 11 qershor 1819 me titullin Doktor në Matematikë me të gjitha pikët dhe më fletë lavdërimi (a pieni voti e con lode).

Në këtë periudhë nevojat për inxhinierë ishin të mëdha e mundësitë për punësim të shumta. Karli nuk vonoi të punësohej në administratën shtetnore, në sektorin e ndërtimit "Inspezione Centrale d'Acque e Strade"

të Venecias si inxhinier, e pak kohë më vonë në Departamentin e Ndërtimit të Rugëve si vullnetar. Punimet e tij të para i filloi në provincën e Bellunos, ku po hapej rruga malore nga Pieve di Cadore nëpër Cortina deri në Toblach. Si inxhinier i klasit të I, vazhdoi të punojë në sektorin e ndërtimit të Bashkisë së Trevisos e po kështu si inxhinier i deleguem për

ik të Nonius-it dhe e botoj në librin "DELL' OTTANTE A DIOTTRA" që e bani të njohut edhe si autor i librash të specializuem. Këtë studim ai e zhvilloi më vonë praktikisht në ndërtimin e hekurudhave.

Për të gjithë këto rezultate të shkëlqyera punët, në vjetin 1836 ai mori një propozim nga banka Rothschild në Vjenë, që të punësohej për 4 vjet

lokomotive do të përshkohej naltësia e Semmeringut, Seilbahn (Lokomotivë me fije çeliku), Lokomotivë me shtytje atmosferike apo një Lokomotivë mbi parimin e forcës së fërkimit? Edhe vetë babai i hekurudhave Stephenson ishte skeptik për realizimin e kësaj hekurudhe malore. Shumë profesionistë e quajtën projektin e Karlit si "fantazia e një të çmen-

ditës profetizonte me keqdashje që "një ndër 10 udhëtarë do të shkojë në djall". As letra paralajmëruese e shoqatës së arkitektëve nuk e theu këmbënguljen e Ghegës për zbatimin e projektit, i cili pat mbështetjen e shefave të tij bile edhe të oborrit perandorak në Vjenë. Kështu u vendos në mbledhjen e këshillit të ministrave të datës 1 mars 1849 që drejtohej nga vetë Kaiseri Franz Josef I, që punimet e sapo fillueme në Gloggnitz të vazhdonin me përparësi deri në përfundim. Në këtë kohë ekonomia ishte në krizë dhe papunësia ishte shumë e madhe, prandaj ndërtimi i hekurudhës do të kishte një vështirim pozitiv social në ndryshimin e mirëqenies së familjeve. Në fillim sillshin në Gloggnitz nga Vjena me tren mijëra punëtorë, por më vonë u krijuan nga nevojja kampe të qëndrueshme banimi për punëtorët. Për punën intensive e të pandërprerë në zonën e Semmeringut, nga kureshtarët e shumtë të asaj kohe flitej: "ato po gërmojnë, theyjnë e plasin shkëmbij, rrezojnë diga dhe hapin rrugën e projektueme përgjatë bllokut malor deri mbrapa malit, ku rruga harkohet tuj e përpi gojë të shkëmbore të tuneleve në mbrendësi e thellësi, ditë e nate, ditë diele dhe festa, verë e dimën..."

Kështu u ba realitet ndërtimi i hekurudhës malore së Semmeringut nën drejtimin e Dr. Karl Ghegës, një vepër mjeshtërore e paparë deri në atë kohë, në lartësinë 437 metra (në Gloggnitz), e cila kalon mbi mure mbrojtëse solide, mbi rreth 100 urave monumentale që përshkojnë luginat, shpesh edhe dy katëshe në mes mbravit shkëmbor të maleve e 15 Tuneleve, 16 Viadukte (një ose dykatësh), që ishin kryevepra të artit arkitekturor për nga bukuria. Në 6 vjetët e ndërtimit u lëvizën rreth 700 000 metër kub material shkëmbor/gurë. Tuneli kryesor i kishte gjatësinë 1430 metër dhe ishte në naltësinë 895 metër mbi nivelin e detit. Por zbatimin e këtij projekti tuj e the vështirësitë e veta. Mu në mes të procesit intensiv të punës në 1850-tën në mes të punëtorëve u përhap kolera nga ku vdiqën 300 punëtorë. Aksidentet në punë nga shkarjet



Në foto: (Majtas) Hekurudha malore e Semmeringut ndërtuar nën drejtimin e Dr. Karl Ghegës, një vepër mjeshtërore e paparë deri në atë kohë, në lartësinë 437 metra (Djathtas) Kjo është lokomotiva Vindobona që u paraqit në konkurs e ndërtueme nga fabrika e hekurudhave Eien - Gloggnitzer në Vjenë



të gjitha zonat e verit të Italisë. Ai drejtoi ndërtimin e rrugëve në Conegliano, Ceneda - Seravalle dhe rregullimin e lumit Po. Në të njëjtën kohë ai merrej me planifikimin dhe projektimin e ndërtesave zyrtare shtetnore si godinën e Bashkisë, Burgjet, Gjykatat në Treviso. Për merita të mëdha e rezultate të larta në punë, në 7 vitet e para të karrierës, ai u nderue me 18 dekrete mirënjohje. Përveç punës së tij në terren, ai merrej me studime teorike, që sollën si rezultat dy zbulime të randësishme për të cilat u dekorue me dy URDHERA NDERI. Zbulimi i parë ishte NIVELLIERLATTE (shtyllën niveleuse) në vitin 1831 dhe i dyti në vitin 1833, NONIUS-IN (vegël që përdorej për stakimin e harqeve).

Në tetorin e vitit 1831, në ndarjen e çmimeve e ndërtimeve për shpikjet në sektorin e industrisë, ai u nderue për zbulimet e tij me medaljen e argjendit të "Cesareo Imperiale Reale Istituto Lombardo - Veneto per le scienze, Lettere ed Arti".

Me 1833 përfundoi studimin teor-

ik të Nonius-it dhe e botoj në librin "DELL' OTTANTE A DIOTTRA" që e bani të njohut edhe si autor i librash të specializuem. Këtë studim ai e zhvilloi më vonë praktikisht në ndërtimin e hekurudhave.

Për të gjithë këto rezultate të shkëlqyera punët, në vjetin 1836 ai mori një propozim nga banka Rothschild në Vjenë, që të punësohej për 4 vjet

lokomotive do të përshkohej naltësia e Semmeringut, Seilbahn (Lokomotivë me fije çeliku), Lokomotivë me shtytje atmosferike apo një Lokomotivë mbi parimin e forcës së fërkimit? Edhe vetë babai i hekurudhave Stephenson ishte skeptik për realizimin e kësaj hekurudhe malore. Shumë profesionistë e quajtën projektin e Karlit si "fantazia e një të çmen-

duri" e vetë atë një "sharlatan që po shfarosë paret e shtetit", bile u thirr në parlament një komision hetimit kundër idesë se Karl Ghegës. Shtypi



Cdo të premte Lounge Bar, me gërmime 200L Lounge Drink,
Cdo të shtune Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela
Cdo ditë një menu e pasur me gatime shtëpie dhe Italiane.
Cdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpie, dhe një pjatë.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA
Cel. 0696070651

INXHINIERI | ARKITEKT

vijon nga faqja 19



...e masivëve shkëmborë apo shembje të galerisë në Veinzettel i kushtoj jetën 13 punëtorëve. Megjithë pengesat e mëdha, Karl Ghega arriti që të mbaj nalt ritmin e punës e kështu me datën 25 qershor 1851 ai bani provën e parë të hekurudhës duke përshkue me lokomotivën "Save", në fillim gjatësinë deri në Payerbadh e mbas pak ditësh deri në Kùb. Krenar raporton Karli te ministri i tij Dr. Baumgartner që prova kaloi me sukses dhe jam i lumtur që ma në fund besimi Juej tek unë u vërtetue. Edhe kundërshtarët e Ghegës pranuen dështimin e tyne.

Lindi nevoja e konstruktimit të një lokomotive të përshatshme për këtë zonë malore e për këtë Karl Ghega me lejen e superiorve shpalli një konkurs nga 13 gushti deri me 16 shtatori 1851, ku morën pjesë firmat më të njohuna të konstruksionit të lokomotivave në botë. Ghega vertetoi që ishte jo vetëm mjeshër arkitekt, por edhe njohës i mirë e teknikës së lokomotivave. Ai vendosi që për hekurudhën e Semmeringut të përdorej Lokomotiva VINDOBONA. Këtu u duk se mbaroi rruga e mundimeve për inxhinierin arkitekt Karl Ghega i cili me 12 prill 1854 së bashku me Perandorin Franz Josef I, përshkoi për herë të parë naltësinë e Semmeringut. Disa ditë ma vonë ai shoqëroj edhe Perandoreshën e re Elisabet po në këtë udhëtim." Për arritje të shkëlqyera, në punë, Karli u nderue me "ORDEN DER EISERNEN KRONE 3. KLASSE" (urdhëri i kunorës së hekurt i klasë tretë) dhe ju dha titulli RITTER (Kalarës/Cavaliere) e Ritterkreuz des Leopolds Ordens (kryqi i hekurt i urdhërit të Leopoldit). Tashma ai thirrej Carl Ritter von Ghega.

Në të gjithë karrierën e tij ai u nderue me këto tituj e medalje:

- Këshilltari Ministror e Perandorak (1844)
- Qytetar nderi i Triestes dhe Brünn-it
- Kommandador i urdherit të Franz Josefit
- Kavaler (Ritter) i urdhërit të kunorës së hekurt të klasës së III (1849)
- Kavaler (Ritter) i urdhërit të Leopoldit
- Kommandador i urdhërit të Josefit në Toskanë
- U vendos në altarin e burrave të mëdhej të kombit (1851)

Përveç karrierës të pakrah-sueshme si inxhinier dhe arkitekt, Karli pat edhe anën tjetër të jetës, atë private, për të cilën nuk ka shumë të dhëna. Ai ishte në përgjithësi njeri i vetmuar, kalonte një jetë të thjeshtë e pa pretendime. Ai banonte i vetëm në qendër të Vjenës, në Bashkinë e parë dhe i pamartuar. Respekti që patën kolegët e punës për të shprehet me




Në foto: (Majtas) Foto e vitit 1858, para sëmundjes se Ghegës (Lart) Skeda e vdekjes e Karl Ghegës e nxjerrë nga arkiva e Katedrales Shën Stefanit në Vjenë (Djathtas) Varri i Carl Ritter von Ghega ne Zentralfriedhof ne Vjene.(Foto P.Logoreci)



CARL RITTER VON GHEGA

Si e ndërtoi hekurudhën gjigante në lartësinë 437 metra

Pse nuk i besonin? Çfarë thoshte opinioni publik, çfarë shkruanin gazetat? Si u krye me sukses një vepër mjeshtrërore, e para në botë e kësaj natyre...?



Në foto: (Majtas) Pilaka monumentale në nderim të veprës gjjeniale të Karl Ghegës ne Semmering / Austri (Foto: P.Logoreci) (Lart) Semmering, në sfond veptrat monumentale të arkitektit Karl Ghega (Foto: P. Logoreci)

fjalët: ishte i dashtun me të gjithë, plot me humor, si në ditët e vështira ashtu dhe në të mira, ishte ai që dinte gjithmonë të kapërcente situatat e vështira me humorin e tij shumë njerëzor që paqësonte e freskonte këdo...Kjo ishte bota e mbrendëshme e një njeriu me pikësynime të qarta në jetë e me besim të plotë në aftësitë e veta. Me gjithë nderimet që ju banë atij, në shkrimet e ndryshme për te nënvizohet me forcë fakti që mbas mbarimit të hekurudhës, ai u keqtraj-

tue e u la në harresë nga institucionet qëndrore të shtetit, gjë që solli deziluzion në personalitetin e tij e si rezultat sëmundja e depression. Atij ju rishfaq sëmundja e vjetër e mushknive që i kushtoj edhe jetën. Në këtë kohë të papërshatshme për te e "transferuen për punë" në një zonë të largët sic ishte Siebenbürgu (vend afër Detit të Zi). Ai vdiq në moshën 55 vjeçare, i lënë në harresë dhe i anashkaluem nga opinioni.

Me vdekjen e tij qarkulluen shumë fjalë për një vetëvrasje. Edhe

në librat e shkollave deri në vitet '60, fundi i jetës se tij shihej si suizid (vetëvrasje). Pat edhe autorë si Richard Mauterer që në librin e tij mbi historinë e hekurudhës së Semmeringut (Richard Mauterer: Semmeringbahn - Daten, Fakten, Propaganda. Signale-Verl., Eien, 1990), në faqen 157 pohon vetëvrasjen e Ghegës. Kësaj supozimesh pat edhe në Itali. Në të vertetë ekziston në arkivën e famullitës së Shën Stefanit, në rrugën ku ai banoi, skeda e vdekjes së tij. Aty përshkruhet qartë nga famullitari i Katedrales, i cili i dha shërbimet e fundit fetare, që ai vdiq me 14 mars 1860, në orën 1 mbas

dreke, në apartamentin e tij në Rotenturmstrasse 6, mbasi mori të gjithë sakramentet. Shkaku i vdekjes: tuberkulozi i mushkënive.

Dy ditë ma vonë kufoma e tij u dërgue nga Katedralja e Vjenës ku ju ba shërbesa fetare, në varrezat popullore të Eähringer-it ku ishin edhe Beethoven e Shubert të varrosur. Varrimi u ba në prani të tri motrave të tij (Theresia Centinari, Angela von Salviolo e Josefine Ghega) dhe të shumë miqve e bashkëpunëtorëve të tij. Në vitin 1887, me krijimin e varrezës qëndrore të Vjenës, eshtrat e tij u transferuen në një varrezë nderi në parcelën e figurave ma të nderueme të kombit.